

KËRKESË
Nr. 62/4, datë 7.4.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimet shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Shtesë e impiantit të Përpunimit të ujit të pijshëm Bovillë me 1 800 l/sek, në fazën e dytë të zbatimit me 1 200 l/sek”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë sh.a.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, si:

1. Për pasuritë e llojit “truall” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”;

2. Për pasuritë e llojit “ndërtesë me funksion banimi”, referuar VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamzë–Vorë, nuk ka deklaruar çmimin mesatar të shitblerjes dhe grupi i punës në terren i UKT sh.a. nuk është lejuar për të finalizuar nxjerrjen e çmimit me metodën e kostos së ndërtimit, në këto kushte vlerësimi paraprak i objekteve të shpronësimit, është bazuar në udhëzimin nr. 3, datë 28.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i banesave, për vitin 2016”.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë sh.a., si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 11,056,007.60 (njëmbëdhjetë milionë e pesëdhjetë e gjashtë mijë e shtatë pikë gjashtëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni

LLOGARITJET PARAPRAKE PËR PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “SHITESË E IMPIANTIT TË PËRPUNIMIT TË UJIT TË PIJSHËM BOVILLË ME 1 800 L/SEK, NË FAZËN E DYTË TË ZBATIMIT ME 1 200 L/SEK”

Nr.	PRONARI			Të dhënat mbi pasurinë sipas ASHK-së				Vlerësimet për shpronësim sipas llojit të pasurisë						VLERA TOTALE (lekë)	Shënime
	Emër	Atësia	Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Lloji i pasurisë	Sip. totale truall (m²)	Shpronësim tokë “truall”			Shpronësim ndërtesë banimi (shtëpi)				
								Sip. truall i prekur (m²)	Çmimi truall lek/m²	Vlera e truallit në lekë	Sip. ndërtesës e prekur (m²)	Çmimi obj.lek/m²	Vlera në lekë		
1	Shkëlzen	Nikoll	Beka	1066	59/20	truall	211.8	161.80	3,560	576,008	70.60	32,113	2,267,177.80	2,843,185.80	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Kamzë Vorë
2	Shkëlzen dhe Sugare		Beka	1066	59/26	truall	366.6	366.60	3,560	1,305,096	122.20	32,113	3,924,208.60	5,229,304.60	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Kamzë Vorë
3	Mirash	Fran	Pjetri	1066	59/27	truall	118.9	118.90	3,560	423,284	76.40	32,113	2,453,433.20	2,876,717.20	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Kamzë Vorë
4	Ylber dhe Pashkë		Mrishaj	1066	59/29	truall	500	30.00	3,560	106,800	-			106,800.00	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Kamzë Vorë
Vlera totale paraprake								677.30		2,411,188	269.20		8,644,819.60	11,056,007.60	

Shënime

1. Për tokën truall, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, datë 3.2.2016.

2. Llogaritjet paraprake të pasurive të kësaj liste, në kushtet kur Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamzë Vorë, nuk ka deklaruar çmimin mesatar të shitblerjes dhe grupi i punës në terren i UKT sh.a. nuk është lejuar për të finalizuar me nxjerrjen e çmimit me metodën e kostos së ndërtimit , vlerësimi paraprak i objekteve të shpronësimit, është bazuar në udhëzimin nr. 3, datë 28.12.2016 të Këshillit të Ministrave , “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”.